

Siguria dhe shëndeti në punë është shqetësim për të gjithë.
Është mirë për ju. Është mirë për biznesin.

Vende Pune të Shëndetshëm
**Të punojmë së bashku
për parandalimin e riskut**



www.healthy-workplaces.eu



Agjensia Europiane
për Sigurinë dhe
Shëndetin në Punë



Vende Pune të Shëndetshëm



Fushata

Çdo 3.5 minuta dikush vdes në BE si pasojë e një aksidenti në punë apo për shkak të një sëmundjeje që ka lidhje me punën. Agjensia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA) ka për qëllim që t'a ulë këtë normë vdekjeje nëpërmjet përmirësimit të sigurisë dhe të shëndetit në mbarë Europën. Fushata *“Të punojmë së bashku për parandalimin e riskut”* përbën një pjesë të Fushatës Europiane që po zhvillohet për Vende Pune të Shëndetshëm, e cila ka ndihmuar që të futen përmirësime të konsiderueshme në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë në të gjithë BE-në dhe më gjërë.

Edhe pse drejtuesit dhe organizatat që ata udhëheqin janë përgjegjësit kryesorë për të garantuar sigurinë dhe shëndetin në punë, rezultatet më të mira janë arritur kur ata kanë angazhuar në mënyrë aktive punonjësit e tyre si dhe përfaqësuesit e punëtorëve. Për këtë arsye, fushata ka dy elementë kryesorë.

Së pari, **ajo i inkurajon drejtuesit që të demonstrojnë lidërsipin në fushën e sigurisë dhe të shëndetit**, duke u konsultuar me të vërtetë me punonjësit e tyre dhe duke zbatuar strategjitë më të mira për parandalimin e riskut.

Së dyti, **ajo i inkurajon punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre që t'i shkëmbejnë idetë dhe të punojnë në mënyrë aktive me menaxherët e tyre** për të përmirësuar sigurinë dhe shëndetin në punë për të gjithë.



Kush mund të marrë pjesë?

Fushata Vende Pune të Shëndetshëm është e hapur për të gjitha organizatat dhe individët në nivel lokal, kombëtar apo European, duke përfshirë:

- të gjithë punëdhënësit në sektorin publik dhe privat;
- drejtuesit, supervizorët dhe punëtorët;
- sindikatat dhe përfaqësuesit e sigurisë;
- të gjitha organizatat dhe individët që i janë përkushtuar përmirësimit të sigurisë dhe të shëndetit.

Si mund të përfshihen juve?

Ju mund të përfshihen në fushatën Vende Pune të Shëndetshëm 2012-13 nëpërmjet:

- shpërndarjes dhe publikimit të informacioneve dhe të materialeve të fushatës, me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi mbi sigurinë dhe mbi shëndetin në punë, si brënda organizatës së suaj, ashtu edhe tek ata me të cilët ju punoni. Ju do të gjeni një shumëllojshmëri materialesh për fushatën, të cilët janë disponibël për shkarkim në 24 gjuhë në faqen e internetit të kësaj fushate (www.healthy-workplaces.eu);
- organizimit të aktiviteteve për vehten tuaj, duke përfshirë edhe trajnimin për të qenë të informuar mbi problemet e sigurisë dhe të shëndetit, nëpërmjet konferencave dhe seminareve, konkurseve apo pyetsorëve, skemave për formulimin e sugjerimeve, fushatave reklamuese dhe konferencave për shtyp;
- pjesëmarrjes në “Konkursin e vlerësimit të praktikave të mira”, i cili evidenton organizatat e madhësive të ndryshme, të cilat kanë zbuluar mënyra të reja për të promovuar sigurinë dhe shëndetin;

Parandalimi është më i mirë se mjekimi



- pjesëmarrjes në Javën Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, e cila mbahet çdo vit në tetor (java e 43-të kalendarike) dhe që vepron si një kornizë për ngjarjet në të gjithë Europën;
- duke u bërë një partner zyrtar i fushatës së BE, nëse ju jeni një organizatë apo kompani gjithë europiane apo ndërkombëtare;
- duke u bërë një partner kombëtar i fushatës, nëse ju jeni një person fizik apo organizatë aktive në nivel kombëtar.

Datat kryesore

- Fillimi i fushatës: 18 prill 2012
- Javët Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në tetor 2012 dhe 2013
- Ceremonia e dhënies së çmimeve për praktikën e mirë: Prill 2013
- Takimi në kuadër të fushatës “Vende Pune të Shëndetshëm”: Nëntor 2013

Përfitimet e menaxhimit nga ana e drejtuesve dhe pjesmarrja e punëtorëve:

- kosto të reduktuara dhe produktivitet i rritur;
- një fuqi punëtore më e kënaqur dhe më produktive;
- mungesat e punëtorëve në punë dhe normat e qarkullimit janë më të ulta;
- ka më pak aksidente;
- reputacioni tek ata që i mbështesin dhe tek partnerët është më i mirë;
- ndërgjegjësim më i madh dhe kontroll i risqeve në vendin e punës;
- një reputacion më i mirë për përgjegjësitë e përbashkëta sociale tek investitorët, klientët dhe tek komuniteti.

Vende Pune të Shëndetshëm është fushata më e madhe Europiane për sigurinë dhe shëndetin në punë.



*Roli udhëheqës i drejtuesve
dhe pjesmarrja e punëtorëve*



Agjensia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), kontribuon për ta bërë Europën një vend më të sigurtë, më të shëndetshëm dhe më produktiv për punë. Agjensia bën kërkime, zhvillon dhe shpërndan informacione të besueshëm, të balancuara dhe të paanshëm mbi sigurinë dhe mbi shëndetin si dhe organizon fushata ndërgjegjësimi gjithëeuropiane. E ngritur nga Bashkimi Europian në vitin 1996 dhe e bazuar në Bilbao, Spanjë, Agjensia mbledh së bashku përfaqësues nga Komisioni Europian, nga Qeveritë e Shteteve Anëtare, nga organizatat e punëdhënësve dhe ato të punëmarrësve si dhe ekspertë drejtues në secilin nga Shtetet Anëtare të BE-27 dhe përtej.

Fushata për Vende Pune të Shëndetshëm është mbështetur nga Presidenca e Këshillit të BE, nga Parlamentit Europian, nga Komisioni Europian si dhe nga Partnerët Socialë Europianë dhe është e koordinuar në nivel kombëtar nga rrjeti i pikave fokale të Agjensisë (www.healthy-workplaces.eu/fops).

Agjensia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Gran Vía 33, 48009 Bilbao, SPAIN
Tel. +34 94 479 4360
Fax +34 94 479 4383
E-mail: information@osha.europa.eu
www.healthy-workplaces.eu